



Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

Prishtinë,

16.07.2026

OPINION PROFESIONAL

MBI KOMPETENCAT E STOMATOLOGJËVE NË TRAJTIMET ESTETIKE JO-KIRURGJIKE NË RAJONIN PERIORAL DHE ORO-FACIAL

1. HYRJE

Në dekadën e fundit është vërejtur një rritje e konsiderueshme e përdorimit të procedurave të mjekësisë estetike jo-kirurgjikale në rajonin perioral dhe oro-facial, veçanërisht trajtimet me aplikimin e toksinës botulinike (*Botox*) dhe mbushësve dermalë (*dermal fillers*).

Këto procedura përdoren jo vetëm për qëllime estetike, por edhe për indikacione funksionale dentare dhe maksilofaciale, si:

- trajtimi i bruksizmit,
- menaxhimi i disfeksioneve të nyjes temporomandibulare,
- korrigjimi i *gummy smile* ("buzëqeshje me gingiva të dukshëm")
- relaksimi i muskujve hiperaktivë në rajonin oro-facial.

2. QËLLIMI I OPINIONIT

Qëllimi i këtij opinionioni është:

- të analizojë kornizën ligjore në Republikën e Kosovës lidhur me kompetencat e stomatologëve;
- të shqyrtojë praktikën ligjore dhe profesionale ndërkombëtare;
- të vlerësojë nëse dhe në çfarë kushtesh mund të konsiderohet përfshirja e stomatologëve në trajtime estetike jo-kirurgjikale;
- të ofrojë rekomandime profesionale për Ministrinë e Shëndetësisë në rregullimin e kësaj fushe.

3. BAZA LIGJORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Korniza ligjore që rregullon ushtrimin e profesionit të stomatologjisë në Republikën e Kosovës përfshin:

- Ligjin për Shëndetësi,
- Ligjin për Odën e Profesionistëve Shëndetësorë,
- Aktet nënligjore përkatëse,
- Rregulloret profesionale të Odës së Stomatologëve të Kosovës.

Nga analiza e legjislacionit aktual rezulton se nuk ekziston një rregullim specifik për procedurat estetike jo-kirurgjikale, si Botox dhe mbushës dermal.

Po ashtu, legjislacioni aktual nuk përmban autorizim të shprehur për kryerjen e këtyre procedurave nga stomatologët dhe nuk përcakton kushtet profesionale për ushtrimin e tyre.

4. PRAKTIKAT NDËRKOMBËTARE

Analiza e praktikave në Bashkimin Evropian dhe në vende të tjera tregon se nuk ekziston një model unik rregullimi për përfshirjen e stomatologëve në procedurat estetike jo-kirurgjikale. Në disa shtete stomatologët lejohen të kryejnë procedura të caktuara estetike, zakonisht:

- pas përfundimit të trajnimeve të specializuara;
- brenda kufijve anatomikë të rajonit oro-facial;
- nën mbikëqyrjen e standardeve profesionale dhe rregullatore.

Në shtete të tjera ekzistojnë kufizime të pjesshme ose të plota, ose kërkohet trajnim dhe certifikim shtesë i detyrueshëm.

Një nga elementet kryesore që ndryshon ndërmjet shteteve është përcaktimi i kufijve anatomikë të kompetencës profesionale të stomatologëve. Këta kufij variojnë nga modele më restriktive deri te modele më gjithëpërfshirëse që përfshijnë një pjesë të konsiderueshme të rajonit të kokës dhe qafës.

Në Itali, Kroaci, Qipro, Estoni, Greqi, Irlandë, Luksemburg, Maltë, Rumani, Slloveni, Sllovaki dhe Suedi, kompetenca e stomatologëve konsiderohet e autorizuar të paktën brenda kufijve anatomikë të përcaktuar nga Direktiva 78/687/EEC, e cila përfshin "gojën dhe nofullat, përfshirë indet e lidhura me to".

Në Gjermani, interpretimi i kompetencës anatomike është dukshëm më kufizues dhe lidhet kryesisht me rajonin e vermilionit të buzëve.

Në të kundërt, disa shtete kanë adoptuar një qasje më të gjerë lidhur me fushëveprimin anatomik të këtyre procedurave: Republika Çeke dhe Holanda: indet mbuluese të kokës dhe qafës; Polonia: i gjithë rajoni kranio-facial; Portugalia: të gjitha indet e fytyrës.

Në vendet e rajonit, Shqipëri, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë procedurat estetike jo-kirurgjikale, kryhen kryesisht nga dermatologë, kirurgë plastikë dhe mjekë të trajnuar në mjekësi estetike. Kompetenca e stomatologëve për kryerjen e procedurave estetike jo-kirurgjikale nuk është e rregulluar në mënyrë të qartë ose mbetet e kufizuar, ndërsa përdorimi i tyre në indikacione terapeutike të lidhura me fushën e stomatologjisë pranohet më gjerësisht.

Praktikat ndërkombëtare tregojnë se, edhe pse nuk ekziston një model unik rregullimi, në shumicën e vendeve ku stomatologët lejohen të kryejnë procedura estetike jo-kirurgjikale, ky autorizim mbështetet në kompetencat e tyre profesionale në rajonin oro-facial, në trajnimet shtesë dhe në respektimin e standardeve të sigurisë së pacientit. Për këtë arsye, vlerësimi i kompetencave profesionale të stomatologëve përbën një element thelbësor në shqyrtimin e kësaj çështjeje.

5. PARIMI I SIGURISË SË PACIENTIT

Oda e Stomatologëve të Kosovës konsideron se çdo rregullim i ardhshëm i procedurave estetike jo-kirurgjikale duhet të udhëhiqet nga parimi themelor i mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së pacientit.

Pavarësisht interesit profesional për zhvillimin e kësaj fushe, interesi publik dhe siguria e pacientit duhet të kenë përparësi ndaj çdo interesi tjetër profesional ose ekonomik.

Për këtë arsye, çdo zgjerim i mundshëm i kompetencave profesionale duhet të mbështetet në standarde të qarta të trajnimit, licencimit, mbikëqyrjes profesionale dhe menaxhimit të komplikimeve.

6. ARSYESHMËRIA PROFESIONALE E PËRFSHIRJES SË STOMATOLOGËVE NË PROCEDURAT ESTETIKE PERIORALE DHE ORO-FACIALE

Në vlerësimin e mundësisë së përfshirjes së stomatologëve në procedurat estetike jo-kirurgjikale, është e rëndësishme të analizohen kompetencat profesionale që ky profesion fiton gjatë formimit universitar dhe praktikës klinike. Këto kompetenca nuk përbëjnë në vetvete autorizim për ushtrimin e procedurave estetike, por paraqesin bazën profesionale mbi të cilën mund të ndërtohen trajnime dhe certifikime specifike.

6.1 Stomatologët studiojnë për vite të tëra anatominë e kokës dhe qafës, duke përfshirë:

- muskujt e fytyrës
- nervat (si nervi trigeminal dhe nervi facial)
- enët e gjakut
- strukturën kockore të fytyrës dhe nofullës

6.2 Stomatologët punojnë shumë pranë zonave si:

- buzët
- faqet
- nofulla

- mjekra
- muskujt rreth gojës

6.3 Përvojë e madhe me injeksione

Stomatologët bëjnë injeksione çdo ditë, sidomos anestezi lokale për procedura dentare.

Ata janë trajnuar për të:

- injektuar me saktësi në hapësira shumë të vogla
- kontrolluar thellësinë dhe këndin e gjilpërës
- shmangur nervat dhe enët e gjakut
- menaxhuar dhimbjen e pacientit

6.4 Precizitet dhe kontroll shumë i mirë i duarve

Stomatologjia kërkon kontroll shumë të saktë të duarve, sepse stomatologët punojnë në hapësira shumë të vogla brenda gojës.

Këto aftësi janë shumë të rëndësishme për:

- mikro-injeksione botox
- vendosje precize të mbushësit dermal
- rezultate simetrike estetike

6.5 Kuptimi i balancës së fytyrës

Stomatologët analizojnë shpesh strukturën e fytyrës gjatë planifikimit të:

- ortodoncisë
- implanteve dentare
- protezave dentare
- dizajnit të buzëqeshjes

Stomatologët kuptojnë si dhëmbët, buzët dhe muskujt e fytyrës ndikojnë në pamjen e fytyrës.

6.6 Stomatologët janë të trajnuar për të menaxhuar probleme si:

- reaksione alergjike
- gjakderdhje
- infeksione
- menaxhim të dhimbjes

7. KUSHTET DHE KRITERET PËR OFRIMIN E PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT

Oda e Stomatologëve të Kosovës rekomandon që programet e trajnimit në fushën e aplikimit të Botox-it dhe mbushësve dermalë të organizohen vetëm nga institucione që plotësojnë kushtet dhe kriteret për organizimin e programeve, të trajnimit, të përcaktuara nga autoritetet kompetente.

Subjektet për ofrimin e programeve të trajnimit mund të jenë:

- institucionet e arsimit të lartë të akredituara;
- OSK dhe organizatat profesionale shëndetësore;
- institucionet shëndetësore të licencuara dhe të akredituara për edukim profesional.

7.1 Kriteret për organizimin e programeve të trajnimit

7.1.1 Kriteret organizative

- Të jetë person juridik i regjistruar;
- Të jetë i licencuar për veprimtarinë përkatëse;
- Të ketë program të dokumentuar trajnimi;
- Të ketë sistem të dokumentimit dhe vlerësimit të pjesëmarrësve.

7.1.2 Kriteret infrastrukturore

- Sallë për zhvillimin e pjesës teorike;
 - Ambient klinik për demonstrime dhe ushtrime praktike;
 - Pajisje për trajtimin e komplikimeve;
- Protokolle emergjente dhe procedura operative standarde.

7.1.3 Kualifikimet profesionale të trajnerëve

Trajnerët duhet të kenë:

- Diplomë universitare në mjekësi ose stomatologji;
- Përvojë të dokumentuar në procedurat estetike;
- Trajnim të avancuar në Botox dhe mbushës dermalë;
- Përvojë klinike të dokumentuar në këtë fushë.

7.1.4 Përmbajtja e programit të trajnimit

Programi duhet të përfshijë:

- Anatominë e kokës dhe qafës;
- Anatominë vaskulare të fytyrës;
- Farmakologjinë e toksinës botulinike;
- Karakteristikat e mbushësve dermalë;
- Menaxhimin e komplikimeve;
- Aspektet etike dhe juridike.

8. REZULTATET E PRITSHME TË TRAJNIMIT PROFESIONAL

Duke marrë parasysh natyrën e procedurave estetike jo-kirurgjikale në rajonin perioral & oro-facial dhe nevojën për garantimin e sigurisë së pacientëve, programet e trajnimit duhet të synojnë zhvillimin e njohurive teorike dhe aftësive praktike që u mundësojnë stomatologëve të vlerësojnë, planifikojnë dhe zbatojnë procedurat përkatëse në mënyrë profesionale dhe të sigurtë. Në këtë kuptim, trajnimi rekomandohet të fokusohet në zhvillimin e kompetencave profesionale, njohjen e zonave anatomike relevante të trajtimit dhe arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit.

8.1 Fushat kryesore të trajnimit profesional

- Anatomia klinike e rajonit oro-facial;
- Verësimi estetik i rajonit perioral;
- Përdorimi i toksinës botulinike;

- Përdorimi i mbushësve dermalë;
- Teknikat e injektimit;
- Parandalimi dhe menaxhimi i komplikimeve.

8.2 Fushëveprimi anatomik i procedurave (rajoni perioral dhe rajoni oro-facial)

- Buzët;
- Palosjet (rrudhat/vijat) nazolabiale;
- Rrudhat (vijat) marionetë ;
- Rajoni perioral;
- Rajoni maksillar dhe mandibular, përfshirë indet e buta përkatëse të gojës dhe nofullave).

8.3 Kompetencat e pritshme pas përfundimit të trajnimit

Pas përfundimit të trajnimit, stomatologu duhet të jetë në gjendje të:

- të vlerësojë estetikën e rajonit perioral;
- të planifikojë trajtimin me Botox dhe mbushës dermalë;
- të aplikojë teknika të sigurt të injektimit;
- të shmangë zonat anatomike me rrezik;
- të diagnostikojë komplikimet e mundshme;
- të zbatojë protokollet për menaxhimin e komplikimeve dhe emergjencave

9. QËNDRIMI I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS

Oda e Stomatologëve të Kosovës nuk synon me këtë opinion të zgjerojë apo të përcaktojë në mënyrë të pavarur kompetenca të reja profesionale, pasi kjo çështje është në kompetencë të institucioneve shtetërore përgjegjëse. Qëllimi i këtij opinioni është të paraqesë një vlerësim profesional dhe rekomandime për shqyrtim nga autoritetet kompetente.

Duke u bazuar në analizën e kornizës ligjore në fuqi, praktikave ndërkombëtare, vlerësimit të rreziqeve dhe kompetencave profesionale të stomatologëve, Oda e Stomatologëve të Kosovës konsideron se ekzistojnë argumente profesionale që

justifikojnë shqyrtimin e mundësisë së përfshirjes së stomatologëve në procedura të caktuara estetike jo-kirurgjikale në rajonin perioral dhe oro-facial. Megjithatë, Oda e Stomatologëve të Kosovës konsideron se ofrimi i këtyre shërbimeve nuk mund të mbështetet vetëm në vlerësimin profesional të kompetencave, por duhet të bazohet në:

- një kornizë të qartë ligjore dhe nënligjore;
- standarde profesionale të përcaktuara qartë, përfshirë trajnimet dhe certifikimet përkatëse;
- mekanizma efektivë të kontrollit, licencimit dhe mbikëqyrjes institucionale;
- përcaktimin e qartë të kufijve anatomikë dhe profesionalë të ushtrimit të këtyre procedurave.

Për rrjedhojë, Oda e Stomatologëve të Kosovës vlerëson se shqyrtimi i mundësisë për përfshirjen e stomatologëve në ofrimin e procedurave të caktuara estetike jo-kirurgjikale në rajonin perioral dhe oro-facial duhet të bëhet përmes një procesi të rregulluar institucional, të udhëhequr nga Ministria e Shëndetësisë, me pjesëmarrjen e organizatave profesionale dhe ekspertëve të fushës.

KONKLuzion

Duke marrë parasysh mungesën e një rregullimi të qartë ligjor në Republikën e Kosovës, praktikat ndërkombëtare, kompetencat profesionale të stomatologëve për procedurat estetike jo-kirurgjikale në rajonin perioral dhe oro-facial si dhe nevojën për mbrojtjen e sigurisë së pacientëve, Oda e Stomatologëve të Kosovës konsideron se ekzistojnë argumente profesionale për shqyrtimin institucional të mundësisë së përfshirjes së stomatologëve në procedura të caktuara estetike jo-kirurgjikale. Çdo vendimmarrje në këtë drejtim duhet të bazohet në një kornizë të qartë ligjore dhe nënligjore, standarde profesionale, trajnim të certifikuar dhe mekanizma efektivë të mbikëqyrjes institucionale.

10. REKOMANDIM PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË

Rekomandohet që Ministria e Shëndetësisë:

1. Të hartojë një kornizë ligjore dhe nënligjore për procedurat estetike jo-kirurgjikale.
2. Të përcaktojë profesionistët shëndetësorë që mund t'i kryejnë këto procedura dhe kushtet përkatëse.
3. Të përcaktojë standarde të detyrueshme të trajnimit dhe certifikimit.
4. Të përcaktojë kufijtë anatomikë dhe klinikë të procedurave që mund të kryhen nga stomatologët.
5. Të përfshijë Odën e Stomatologëve të Kosovës në procesin e hartimit të politikave, akteve nënligjore dhe standardeve profesionale që lidhen me përcaktimin e kompetencave të stomatologëve në procedurat estetike jo-kirurgjikale në rajonin perioral dhe oro-facial.

11. REFERENCAT

1. European Commission – Directive 2005/36/EC on recognition of professional qualifications
2. Dental Tribune – Botulinum toxin in dentistry: trends and regulation.
3. Cureus – Botox: Current and emerging trends for dental practitioners in esthetic dentistry.
4. General Dental Council (UK) – Standards for dental professionals.
5. DWF Group – Regulation of aesthetic injectables in Europe.
6. Dental Defence Society – Avoiding pitfalls in facial aesthetics.
7. Vaccaro GL, Di Carlo G, Polimeni A. The use of botulinum toxin for medical-aesthetic purposes in dentistry: a comparative medico-legal approach in the context of the European Union. *Annali di stomatologia*. 2023 Mar 9;14(1):23-7.
8. Ligji për Shëndetësi i Kosovës.
9. Ligji për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë.